



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 27 qershor 2023, në mbledhjen e XIII-të (trembëdhjetë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Qëndrim Softolli; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Sylja; dhe Mrika Thaçi) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe; znj.Marigona Lahu Nënkyetare e Komunës; z.Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, znj.Saranda Stublla, Drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, dhe z.Fatmir Rudari, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, thirrja dhe materiali i kësaj mbledhje ju është dërguar me kohë, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.

z.Naim Çunaku, theksoi, kam një propozim, përkatësisht pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës.

Jeni në dijeni që Komuna e Podujevës është në fazën e formimit të këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe në këtë aspekt nuk e di se si qëndron puna e pagesës së Komisionit për të cilin sigurisht jemi në dijeni për atë komision me aq ditë angazhim bukur të madh, të mos kaloj në Kuvend një vendim për pagesën e tyre, çështje për të cilën po i drejtohem Kryesuesit të Kuvendit që këtë gjë e kemi thënë edhe kur është themeluar ky Komision andaj tani jemi në fazën ku mungojnë Udhëzimet Administrative përkatëse që rregullojnë mënyrën e pagesës së komisioneve, prandaj besoj se vetëm përmes një vendimi të Kuvendit mund të kryhet pagesë për anëtarët e Komisionit.

Nëse edhe ju jeni të mendimit propozoj që ta trajtojmë si pikë të rendit të ditës ose t'i propozojmë Kuvendit ta trajtoj si pikë në kuadër të rendit të ditës.

Vlen të theksohet se në përbërjen e Komisionit në fjalë janë të përfshira të gjitha grupimet politike dhe nuk ka kurrfarë ngjyrimesh politike.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, për këtë çështje mund të na njoftoj më gjerësisht Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave se a është ndërmarrë ndonjë veprim në këtë drejtim dhe a është biseduar për këtë çështje me Drejtoreshën e Drejtorisë së Administratës.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, theksoi, kemi biseduar me bashkërisht, madje edhe jemi takuar me gjithë anëtarët e Komisionit përkatës. E rrugës do të ishte që të parashihej me ndonjë Udhëzimit Administrativ mënyra e pagesës së komisioneve, por që nuk ka një të tillë mirëpo e vetmja rrugë mbetet një vendim i Kuvendit të Komunës. Ka disa komuna që kanë marrë një vendim të tillë për pagesën e anëtarëve të komisionit në fjalë, mirëpo pastaj sfidë mbetet vetëm kthimi i ligjshmërisë së atij vendimi nga ana e Ministrisë përkatëse.

Ne besojmë se komisioni në fjalë duhet të paguhet sepse bën një punë bukur voluminoze, me përgjegjësi, me stres, me afate kohore dhe gjitha çështjet tjera, mirëpo vetëm duhet të zgjidhet modaliteti.

Disa komuna kanë vendosur si një pagesë të përhershme dhe mujore të anëtarëve të komisionit në fjalë edhe pse ata anëtar e kanë një punë të koncentruar në periudhën kur zgjedhën këshillat edhe pse janë me mandat 4 vjeçar sepse për çdo muaj mund të zgjedhet ndonjë këshill, mund të jap dorëheqja ndokush ose raste të tjera të ngjashme e që mund të ketë angazhim, por thjesht që të jetë një pagesë për çdo mbledhje apo për çdo zgjedhje të një këshilli. Pra të përcaktohet një shumë buxhetore për çdo mbledhje, përkatësisht për çdo zgjedhje të një këshilli, të votohet nga Kuvendi i Komunës dhe pastaj të ndiqen procedurat e hyrjes në fuqi të atij vendimi ku ne normal se jemi të obliguar mandej ta zbatojmë atë vendim.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, meqë paska praktika të tilla atëherë besoj se edhe ne mund të ndërmarrim veprime konkrete në këtë drejtim.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, theksoi, lidhur me këtë uroj të mos kemi problem sepse një praktikë tjetër e kam lexuar që një vendim i tillë i'u është kthyer si vendim i paligjshëm nga ana e Ministrisë përkatëse, mirëpo sërish po e përsëris se ne nuk kemi tjetër rrugë sa i përket kësaj çështje dhe ne si DBF nuk kemi të drejtë ta ekzekutojmë asnjë pagesë pa një vendim ose bazë ligjore.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, konsideroj se për çfarëdo që vendosim duhet që paraprakisht ta kemi një propozim konkret në mënyrë që ta dimë se çfarë po hedhim dhe çfarë po vendosim me votim.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, theksoi, unë jam takuar me anëtarët e komisionit në fjalë dhe jua kam shpjeguar komplet këto modalitete, e që edhe disa prej tyre veç janë të njoftuar më parë, mirëpo çështje tjera siç janë përcaktimi i një shume fikse apo shembull ta marrim 50€ për një anëtar për një mbledhje të një këshilli apo ndonjë shumë tjetër buxhetore që mund të shihet si e arsyeshme nga ai komision.

Pra në momentin që ndjekjen procedurat dhe përfundojnë ato pastaj është gjithçka në rregull, mirëpo ndoshta është e domosdoshme që paraprakisht të definohet sakt ai propozim vendim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë mendoj se është mirë që kjo çështje të lihet për mbledhjen e radhës në mënyrë që të përgatitet një propozim konkret. Pra të mos ngutemi në këtë aspekt sepse pagesat mund të kryhen pastaj edhe në mënyrë retroaktive për takimet e mbajtura të komisionit.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, theksoi, pajtohem me Kryesuesin që kjo çështje të shtyhet për mbledhjen e radhës. Sigurisht se në rast se merret një vendim mund të përfshihet edhe një nen i cili rregullon pagesat në mënyrë retroaktive për anëtarët e Komisionit për takimet e mbajtura dhe zgjedhjen e këshillave përkatës.

z.Naim Çunaku, theksoi, propozim e bëra paska në mënyrë gjenerale, mirëpo nëse dikush mendoj se nuk e artikulovala si propozim unë tani po mundohem ta artikuloj atë në këtë formë, dhe atë;

i propozojmë Kuvendit të Komunës që të shqyrtojë mundësinë e pagesës, gjegjësisht shpërblimit të tyre për punën që bëjnë anëtarët e Komisionit në fjalë. Pra kështu diçka duhet të jetë një pikë e formuluar.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, konsideroj se duhet një arsyetim dhe një bazë ligjore sepse këtu është edhe zyrtari i Zyrës Ligjore me të cilët kemi biseduar lidhur me këtë çështje, ngase ne duhet të dimë se çfarë po vendosim.

z.Naim Çunaku, theksoi, e ceka edhe më parë se të gjithë ata anëtarë/e të Komisionit janë kolegë tanë dhe në një formë asnjëri prej tyre nuk është pjesë e KPF-së dhe po i bie që po i anashkalojmë tani në këtë mbledhje, pra i gjithë qëllimi ishte ky. Është e vërtetë se nuk ka më punë vullnetare dhe lidhur me këtë, kur kemi filluar me këto proceduar (Drejtoresha e DA-së) nuk është prezentë këtu, mirëpo unë e kam thënë që kur ta sjellësh propozimin në Kuvend, për çdo projekt të tillë duhet ta sjellësh edhe koston buxhetore, dhe Drejtoresha e DA-së që në fillim kur e ka sjellë propozimin në Kuvend për formimin e këtij komisioni është dashtë ta parasheh edhe koston buxhetore. Ka ndodh ajo çfarë ka ndodh, unë tani e propozova dhe mbetet të vendoset si të vendos shumica këtu.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, theksoi, mendimi im që kjo çështje të lihet për mbledhjen e radhës sepse as nuk është ndonjë humbje për anëtarët e Komisionit në rast se veç kalohen gjitha procedurat ligjore ngase pagesa sigurisht se i'u bëhet edhe për punën të cilën e bëjnë gjatë kësaj periudhe kohore.

Pra në rast se miratohet ai vendim, i njëjti mund të miratohet edhe në mbledhjen e radhës e në të cilin mund të ceket një nen që pagesa e anëtarëve të komisionit do të bëhet për punën që kanë bërë nga fillimi i aktivitetit të tyre, kjo meqë aktiviteti i tyre ka filluar dhe janë mbajta disa takime dhe është zgjedh 1 Këshill, kurse disa të tjerë kanë dështuar sa unë jam në dijeni.

z.Haki Rudari, theksoi, në parim e përkrahë propozimin e kolegut, por në të njëjtën kohë unë mendoj se është mirë që kjo pikë e rendit të ditës të lihet për mbledhjen e radhës në mënyrë që DBF dhe DA natyrisht në konsultim edhe me Zyrën ligjore dhe shërbimet tjera relevante të dalin më sakt lidhur me këtë çështje.

Jemi që ai komision të paguhet, është i formuar prej partive të ndryshme dhe nuk e besoj se ndokush dëshiron t'i jap ndonjë ngjyrim politik kësaj çështje.

Është e vërtetë se janë mbajtur 3-4 takime dhe është zgjedh vetëm një Këshill lokal duke përfshirë edhe kryetarin e Këshillit, por që nuk janë këto probleme të komisionit por janë probleme tjera, prandaj në emër të grupit konsideroj se është më mirë të lihet për mbledhjen e radhës në mënyrë që të jemi më legal në kuptimin e nxjerrjes së një vendimi të tillë, në të kundërtën pastaj mund të kthehet nga MAPL si vendim jo në kuadër të ligjit, dhe këtë meqë ende është fillimi dhe asgjë nuk i'u humb.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, lidhur me këtë çështje unë kam biseduar me shumë Kryesues të Kuvendeve të Komunave të Kosovës. Komuna e Kamenicës ka bërë pagesa në shumë 30€ për një takim por që limitin e kanë pasë deri në 1000€ maksimum, po ashtu Komuna e Lipjanit ka paguar nga 30€, mandej kemi Komunën e Suharekës e cila qëndron më së miri në këtë drejtim dhe i kanë funksional Këshillat lokal, të cilët po ashtu përmes Kuvendit të Komunës kanë bërë pagesa për anëtarët e komisionit. Konsideroj se edhe ne duhet të kemi një vendim me arsyetim dhe ashtu siç po e vërej disponimi i të gjithëve është që anëtarët e Komisionit në fjalë të paguhet e që mendoj se është gjë normale sepse askush nuk del pa pagesë nëpër fshatra dhe vendbanime tjera ku zgjedhën Këshillat e fshatrave, mirëpo duhet të gjejmë mënyrën më të mirë që të mos na kthehet eventualisht si vendim i paligjshëm nga Ministria e Pushtetit Lokal, kështu që unë mendoj se Drejtorja e Buxhetit dhe Financave si dhe Drejtorja e Administratës ta përgatitin një propozim konkret për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit ku pastaj mund ta shqyrtojmë dhe miratojmë, kjo është mënyra më e mirë mendoj.

z.Haki Rudari, theksoi, kemi një praktikë të tillë para disa viteve kur ka qenë i ngritur komisioni për emërtimin e rrugëve, i cili ka paraqitur takimet në terren, është kërkuar pagesë për punën e tyre dhe është marrë vendim në Kuvendin e Komunës duke ndarë një shumë financiare ku pastaj është bërë edhe pagesa.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra unë po vërej se disponimi i të gjithëve ekziston për këtë çështje.

Nga Drejtoritë përkatëse sjellët propozimi, shqyrtohet në Kuvend dhe miratohet, kështu që tani mendoj që nuk ka nevojë fare të hedhet në votim sot.

z.Naim Çunaku, theksoi, unë vetëm e ngrita si çështje, por meqë tani u krijua një qëndrim i tillë, mund të mbetet si qëndrim apo konstatim i KPF-së kjo çështje ashtu siç e ceku Kryesuesi.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, edhe unë konsideroj se mënyra më e mirë është të mos hedhet fare sot në votim dhe po ashtu as në mbledhjen e Kuvendit të mos hyjë si pikë në rend të ditës, por të mbetet si konstatim që për mbledhjen e radhës të sjellët propozim vendimi konkret nga Drejtoritë përkatëse në mënyrë që si KPF dhe si Kuvend ta kemi të qartë se çka po votojmë.

Konstatim:

Unanimisht u mbështet propozimi që për seancën e radhës në kuadër të rendit të ditës të sjellët edhe propozimi për pagesën / kompensimin e anëtarëve të Komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës, i ngritur me vendimin nr.prot.01-020/04-0101084/22 datë 09.12.2022

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të propozuar të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Njëzëri me 9 vota Për, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtura më: 06 prill 2023 dhe 12 maj 2023

Njëzëri me 9 vota PËR, pa vërejtje apo plotësim ndryshime, u miratuan procesverbalet sipas kësaj pike të rendit të ditës

2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Podujevës për periudhën 2024 – 2026

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pra në këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës, dokument ky i cili i paraprinë projekt buxhetit të Komunës për vitin e ardhshëm dhe planifikimet buxhetore për dy vitet pasuese, kështu që fjalën hyrëse ja jap Drejtorit të DBF i cili mund të na jap sqarime dhe shpjegime tjera të nevojshme.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, duke paraqitur këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore 2024 – 2026 e Komunës së Podujevës është një dokument strategjik që i paraprinë hartimit të buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024. Ky dokument ndërtohet dhe hartohet mbi bazë të Qarkores së parë buxhetore të cilën e lëshon Ministria e Financave e që ne pastaj si Komunë dhe çdo organizatë buxhetore është e obliguar që t'i përmbahet limiteve buxhetore të cilat i ka përcaktuar Ministria e Financave.

Për vitin 2024 Komuna e Podujevës ka një rritje buxhetore prej afër 4 milion euro, pra si buxhet total për vitin 2024 është 31,423,020.00€ mirëpo vlen të ceket se pjesa dërmuese e kësaj rritje buxhetore shkon në kategorinë e pagave për shkak të miratimit dhe hyrjes në fuqi të Ligjit të pagave e që ka pasë ndikime buxhetore në të gjitha programet buxhetore qoftë në Arsim, në Shëndetësi, në Administratë e që normale se kjo rritje ka ndikuar që të ketë rritje në kategorinë e pagave, mirëpo ka një rritje edhe në kategoritë tjera buxhetore siç janë te mallrat, te investimet kapitale si dhe një rritje të lehtë edhe te subvencionet.

Përpjekja është bërë maksimale që në këtë KAB të inkuadrohen projektet prioritare të cilat i ka Komuna e Podujevës, sektorët prioritar që i konsideron siç është Arsimi, Shëndetësia, Kultura, Bujqësia e cila në fakt

vazhdon t'i ketë ato subvencione pa pasë një rritje të buxhetit në këtë kategori nëse krahasojmë me vitet paraprake, si dhe financimin e projekteve prioritare – infrastrukture siç janë ndërtimi i disa rrugëve të rëndësishme në qytet e që parashihen investime në çdo lokalitet të Komunës së Podujevës dhe nëse ndonjë lokalitet nuk parashihet për investime në vitin 2024 pa tjetër parashihet në vitin 2025 ose 2026, prandaj e them se brenda këtyre tri viteve do të ketë investime në çdo lokalitet.

Arsimi ka të planifikuara ndërtimin e disa objekteve arsimore në qytet dhe në fshatra, pastaj ka të planifikuara edhe renovimet e disa objekteve arsimore.

Shëndetësia, me që për kapitale kemi më pak nevojë sepse jemi në fazën e rumbullaksimi të objekteve shëndetësore ngase siç e dimë janë ndërtuar shumë objekte shëndetësore, prandaj ka pak më shumë rritje të buxhetit tek kategoritë mallrave dhe subvencioneve, mirëpo tek kapitalët kemi zvogëlim sepse edhe nevojat tani janë më të vogla në fushën e shëndetësisë.

Nuk dëshiroj të zgjatem më shumë sepse sigurisht që këtë dokument do ta debatojmë në vazhdim dhe po ashtu edhe në mbledhjen e Kuvendit, mirëpo ajo që është me rëndësi dhe që vlen të ceket është se ky dokument i paraprinë hartimit të buxhetit dhe gjatë kësaj periudhe deri në miratimin e buxhetit Drejtoritë e Komunës janë të gatshme t'i marrim propozimet, sugjerimet apo edhe vërejtjet eventuale në mënyrë që në fund ta kemi një buxhet sa më të mirë dhe sa më shumë që i'u përgjigjet nevojave të qytetarëve, normalisht duke pasë për bazë limitet buxhetore.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, sa i parket Kornizës Afatmesme Buxhetore si një dokument bazikë nëpër të cilën në vija të trasha hartohet edhe projektbuxheti i Komunës për vitet 2024-2026, ne si Grup i LDK-së kemi vërejtjet tona pasi nuk shohim ndonjë ndryshim nga projektbuxhetet e viteve paraprake, mirëpo pa dashur të diskutoj shumë rreth kësaj çështje tani sepse në mbledhjen e Kuvendit do t'i paraqesim të gjitha gjetjet, pra ne si Grup i LDK në parim nuk e përkrahim këtë dokument kështu si është.

z.Haki Rudari, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026 e Komunës së Podujevës është një dokument tepër i një rëndësie të lartë ku pasqyrohen caqet e përgjithshme të Komunës siç janë të hyrat dhe shpenzimet në këto kategori të ndryshme apo Drejtori të ndryshme dhe mendoj se një ndryshim i buxhetit nga 27 milion euro në 31,423,020.00€ është një ndryshim i madh për arsye se kemi rreth 4 milion më shumë buxhet dhe në të njëjtën kohë nëse hyjmë në detaje dhe analizojmë nëpër Drejtoritë e Komunës kemi disa rritje të buxhetit nëpër Drejtori të ndryshme si janë ajo e Shëndetësisë, Arsimit, andaj në këtë vijë / aspekt ne Grupi i LVV-së e përkrahim, i japim mbështetje dhe natyrisht në seancën e Kuvendit do t'i japim diskutimet tona varësisht Drejtorive përkatëse.

Nëse e analizojmë më në detaje këtë dokument, ka shumë projekte në qytet, nëpër lagje dhe fshatra të ndryshme qoftë në infrastrukturë, kulturë, sport dhe në të gjitha Drejtoritë ka një ngritje, prandaj në këtë aspekt ne Grupi i LVV-ës i japim përkrahje duke konsideruar se është një KAB e cila është afër qytetarëve, edhe pse kërkesat dhe nevojat e qytetarëve janë të mëdha gjë të cilën e kam potencuar edhe më parë se po ta kemi një buxhet të Londrës apo të ndonjë qytetit tjetër të madh europian ndoshta do të mund t'iu vinim arsye të gjitha kërkesave dhe nevojave të qytetarëve, mirëpo me një buxhet me një rritje prej 4 milion euro është diçka që vërehet dhe diçka që nuk mundemi ta anashkalojmë, ndërsa për çështje tjera do të japim kontributin tonë edhe në mbledhjen e Kuvendit.

z.Bashkim Sylja, theksoi, edhe ne Grupi i PDK-së e përkrahim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024 - 2026 dhe natyrisht se në mbledhjen e Kuvendit do të japim sugjerime dhe vërejtje eventuale.

z.Naim Çunaku, theksoi, ajo që më bëri të marrë fjalën është fjalia e kolegut parafolës zotëri Rudari kur e potencoi se KAB është afër qytetarëve dhe për qytetarët, unë kam vetëm një kërkesë dhe atë, a mund të bëhet që këtij dokumentacioni të KAB t'i bashkëngjitet edhe raporti nga diskutimet publike në mënyrë që ta shohim se kanë marrë pjesë qytetarët në hartimin e kësaj Kornize dhe sa janë marrë përsipër kërkesat e qytetarëve në hartimin e projekteve që janë me rëndësi vitale për qytetarët.

z.Haki Rudari, theksoi, thirrjet kanë qenë publike për takime, janë mbajtur disa takime dhe mendoj se aspekti ligjor është përfunduar.

Çështja tjetër, i nderuar zotëri Çunaku, 31,423,020.00€ janë shumë e madhe buxhetore që shkon tek qytetarët, dhe nëse tani hyjmë tek Drejtoritë e Komunës dhe shohim investimet mund të themi se nuk ka fshat apo edhe lagje që nuk ka investime, prandaj edhe këto janë të qytetarëve dhe nuk është KAB vetëm për DBF apo vetëm për Ekzekutivin, nuk është i dedikuar vetëm për Grupin e LVV-së por është dokument i dedikuar për qytetarët, për fshatrat dhe për lagje të ndryshme, prandaj e potencova se në këtë vijë / aspekt është i rëndësishëm sepse shkon tek qytetari me mjete të ndryshme qoftë infrastrukturë, ndërtim të shkollave, shëndetësi ku kemi një rritje në shumë 200,000.00€ për qytetarët që kanë sëmundje të rënda, andaj nuk është një diçka ku ne mund t'i mbyllim sytë para kësaj.

Nëse hyjmë dhe shohim nëpër Drejtori ka shumë fshatra të tëra në të cilat realisht jetojnë qytetarët, prandaj e përsërisë se ky KAB është i qytetarit për arsye se mjetet dhe investimet bëhen për lagje dhe fshatra të ndryshme.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, kjo praktik e investimeve nëpër fshatra dhe lagje nuk risi që po ndodh vetëm tani sepse është bërë çdoherë, pastaj edhe rritja e buxhetit është trend që ndodh dhe ka ndodh vazhdimisht ku secilin vit buxheti shkon duke u rritur.

z.Haki Rudari, theksoi, nuk e thash se nuk është investuar, por e potencova se buxheti shkon tek qytetari dhe ka qenë edhe në të kaluarën tek qytetari si dhe do të jetë edhe në të ardhmen.

z.Naim Çunaku, theksoi, u tha se takimet kanë qenë publike mirëpo unë e them se është tmerr çka është duke ndodh me informimin e qytetarëve. Ne kemi një Udhëzim Administrativ për standardet minimale të konsultimeve me publikun të cilin mund ta hapë ndokush dhe ta shohë se sa i'u kemi përmbajtur atij Udhëzimi.

Çështja tjetër është kjo, po nisem nga lokaliteti prej nga vij unë, të më përmirësoj Drejtori i DBF-së nëse jam gabim, në njoftimin përkatës shkruan kështu, *takim publik me qytetarët Lluzhan*, pra ky ka qenë njoftimi i nderuar dhe kur thuhet *me qytetarët Lluzhan*, çdo njeri që kupton nga ajo që lexoj i bie që bëhet fjalë për fshatin Lluzhan, dhe nuk e merr mundimin ndokush nga qeverisja që ta shkruaj në atë njoftim se cilët persona dhe cilat fshatra mund të marrin pjesë në takim.

Pra është për keqardhje që në një takim ku kanë qenë të ftuar nga rrethinat e fshatrave Gllamnik, Popovë, Lupç, Halabak, Batllavë e që janë mbi 40 fshatra me mbi 18000 banorë, të marrin pjesë vetëm 2 qytetarë, këtu gjithçka mund të thuhet por konsultim me qytetarin nuk mund të thuhet. Të paktën qysh e përcakton Udhëzimi Administrativ, jo qysh e thotë dikush e që në këtë rast jam unë që e thash.

Ndërsa sa i përket rritjes së buxhetit, kemi thënë disa herë se vlera monetare e buxhetit të Republikës së Kosovës është rritur, pse është rritur sigurisht se jeni në dijeni kur kemi pas 1 litër vaj 1 € dhe aty janë marrë për TVSH 18% apo 18 cent, kurse tani është 3 € dhe nuk është më 18% por është mbi 40% TVSH, andaj edhe është rritur vlera e buxhetit të Republikës së Kosovës, ndërsa formula e ndarjes së buxhetit është e njëjtë, ne mund të themi çfarë dëshirojmë por të më thotë ndokush a ka ndryshuar formula e ndarjes së buxhetit për Komunat, jo është e njëjta, vlera nominale rritet, inflacioni rritet, mirëpo vlera e vërtetë e asaj është vetëm të arrihet 100%.

z.Haki Rudari, theksoi, i nderuar Kryesues nuk mund të ndërhysh në diskutimin tim, ti as askush tjetër sepse unë jam shef i Grupit të LVV dhe i jap sqarimet e mia, kurse drejtori i DBF jep sqarimet e veta, prandaj në raport me mua përmbaju Rregullores dhe mos më ndërhyj më ngase unë i përmbahem Rregullores 100%.

I nderuar zotëri Çunaku, prej vitit 2013 jam pjesë e Kuvendit të Komunës, me disa përjashtime, gjithë kohën këto kanë qenë, njoftimi për qytetarët përfshinë datën, vendin, orën.

z.Naim Çunaku, duke ndërhyrë theksoi, nuk dëshiroj të shtyhem me ty por nuk ka qenë kështu sepse në njoftim është treguar në kllapa për cilat vende bëhet fjalë.

z.Haki Rudari, vazhdoi, i nderuar Çunaku mos të hyjmë në atë pjesë sepse njerëz që kanë punuar në Komunë i keni marrë dhe i keni futur në sallën e Kuvendit për të marrë pjesë në debat publik, por të mos kthehemi tani mbrapa.

Pra ato që i ceka janë që i nevojiten një Kuvendi Komunal, data, vendi dhe ora.

A është pjesëmarrje e vogël, natyrisht se po, mirëpo tani cilët janë mekanizmat që rritin pjesëmarrjen e qytetarëve, natyrisht se ka shumë, por në të njëjtën kohë kur parafolësi e tha Lluzhan, natyrisht se nuk mund të shkojnë në çdo fshat, shembull, tek ne është mbajtur në fshatin Sfeçël dhe tani të themi përse nuk është mbajtur në fshatin Shajkoc. Pra është mbajtur në fshatin Lluzhan dhe janë përfshirë lokalitetet përreth, sikurse që është mbajtur në fshatin Sfeçël dhe kanë marrë pjesë fshatrat Dumosh, Shajkoc, Lladoc, Balloc, Surkish, prandaj e them se nuk mund të mbahen në çdo fshat debatet publike.

Për mua është e rëndësishme këto që i potencova, data, ora, vendi, ndërsa e përsëris se sa i përket pjesëmarrjes a është apo jo e kënaqshme natyrisht se jo dhe do të donim të kemi pjesëmarrje sa më të larët të qytetarëve në këto debate.

z.Naim Çunaku, theksoi, unë i thash të gjitha shumë qartë por kur dikush nuk donë të kuptoj, nuk di se çfarë të them më shumë pastaj.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, më vie keq që ne po i akuzojmë qytetarët, por ne kemi organizuar diskutim publik edhe me anëtar të Kuvendit të Komunës së sallën e Kuvendit e që vetëm anëtari i Kuvendit z.Ekrem Rrahmani ka marrë pjesë, kështu që ne nuk kemi edhe shumë të drejtë t'i akuzojmë qytetarët për mos pjesëmarrje në debate të tilla kur ne vet si anëtar të Kuvendit nuk marrim pjesë, kështu që për këtë çështje mund të debatojmë edhe në mbledhjen e Kuvendit.

Thirrja ka qenë për debat publik, Drejtori i DBF ka qenë pjesëmarrës, qytetarët ne po e shohim se po gjejnë mënyra tjera ndoshta për të ardhur deri te realizmi i kërkesave dhe nevojave të tyre, unë kështu mendoj dhe nuk kam qëllim për polemika me askënd.

z.Bashkim Sylja, theksoi, mendoj se çdo vërejtje dhe çdo sugjerim që jepet qoftë prej pozitës qoftë prej opozitës e që konsiderohet se është i mirë, duhet të merret parasysht dhe të përmirësohet çështja konkrete në vitin e ardhshëm.

Sa i përket debateve publike, mendoj se kjo çështja ka ndikuar edhe nga Këshillat e fshatrave sepse po të ishin funksional ata sigurisht se edhe informimi do të ishte edhe më i mirë për banorët e lokaliteteve përkatëse. Besoj se vitin e ardhshëm do të jemi më mirë në këtë aspekt, mirëpo çdo shkelje eventuale, çdo mos informim që paraqitet këtu nuk duhet të merret këtu si sulm ndaj ndokujt dhe pastaj të zhvillohet debat i panevojshëm. Pra nuk e di sa kuptova, çdo sugjerim është i mirëseardhur sepse fundja nëse i konvenon dikujt dhe e sheh se qeverisja ka bërë gabim në ndonjë çështje pastaj në vitin e ardhshëm mund ta përmirësoj atë, andaj nuk ka asgjë të keqe rreth kësaj çështje dhe nuk e di përse po diskutohet kaq gjatë.

z.Naim Çunaku, theksoi, Kryesuesi i Kuvendit e përmendi debatin publik me anëtar të kuvendit të komunës që është organizuar, unë shtroj pyetje, gjema ndokund në tërë rregullativën ligjore një gjë të tillë që e rregullon punën e Kuvendit të Komunës dhe që e ke të drejtën ashtu siç ke vepruar ti Kryesues, unë do të kërkoj falje publikisht. Nuk organizon debate publike Kuvendi i Komunës përkatësisht Kryesuesi i Kuvendit z.Hilmi Hoxha me drejtorin e DBF z.Fatlum Osmani nuk mund të organizoj debat me anëtar të Kuvendit, mirëpo Kuvendi i Komunës është ai që organizon takim me qytetarë.

Kryesuesi i Komitetit, duke i'u përgjigjur parafolësit theksoi, ashtu ka qenë, Kuvendi i Komunës ka organizuar debat me qytetarë por njëkohësisht janë ftuar edhe anëtarët e Kuvendit.

Pra ftesa ka qenë takim me qytetarë ku ftohen edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës që të jenë prezent.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk ka qenë ashtu i nderuar Kryesues dhe këto gjëra janë të publikuara dhe mund të shikohen. Përndryshe unë nuk mund të shkoj në një takim të tillë kur është jashtë proceduarave.

Kuvendet Komunale edhe në të kaluarën kanë organizuar debate dhe takime me qytetarë për KAB dhe projektbuxhet, pastaj ka organizuar edhe Komiteti për Politikë dhe Financa takime të tilla, mirëpo kjo që

ka ndodh nuk është ashtu dhe mos e merrni këtë sikurse me tendencë ngase qëllimi im është për tu përmirësuar kjo qasje jo diçka tjetër, prandaj në këtë aspekt unë vetëm një propozim e kisha, t'i bashkëngjitet KAB-it raportet nga diskutimet publik sepse kjo është edhe obligim ligjor që ndikon pastaj edhe në performancë komunale e që siç e kemi atë e dim të gjithë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, konsideroj se debati për këtë pikë të rendit të ditës përfundoj andaj e hedh në votim që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Nga 9 anëtarë/e të KPF-së, me 6 vota PËR (të tjerët nuk morën pjesë në votim) i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje

3. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2022 në vitin 2023 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, duke paraqitur këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, në mbledhjen e kaluar kemi bërë bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023 mirëpo ato kanë qenë të hyra vetanake nga fondi 21 që nënkupton se të hyrat vetanake të cilat janë realizuar në vitin 2022 dhe që nuk janë shpenzuar në vitin 2022, kurse arsyeja përse sërish kemi bartjen e të hyrave vetanake në këtë seancë është sepse kjo bëhet nga fondi 22 e që nënkupton se bëhet fjalë për të hyrat vetanake që janë realizuar para vitit 2022 dhe të cilat nuk janë shpenzuar në vitin 2022. Do të thotë këto mjete në shumë 151.443.9€ tani e kemi të drejtën në bazë të Ligjit për buxhetin që e ka nxjerrë Qeveria e Republikës së Kosovës ne si komuna kemi të drejtë t'i bartim dhe këtë e kemi propozuar që këto mjete të barten në projektin e ndërtimit të Stacionit të Autobusëve që është një bashkëfinancim mes Komunës dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

znj.Sebastina Vokri, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim propozim vendimin për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2022 në vitin 2023 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore, dhe i rekomandojmë Kuvendit për diskutim dhe votim.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, rreth kësaj vlere buxhetore në shumë 151.443.9€ që po dedikohet për ndërtimin e Stacionit të Autobusëve për të cilin jemi në dijeni se ka qenë një bashkëfinancim mirëpo a ka qenë një vlerë e parashikuar më herët apo vetëm na duhen ato mjete dhe po dedikohen për këtë projekt sepse paksa më duket jo bash e sqaruar kjo çështje.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, sqarim parafolësit, theksoi, ndërtimi i Stacionit të Autobusëve është një projekt që ka filluar dhe është proceduar përmes proceduarve të prokurimit në bazë të një Marrëveshje me Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal. Normale se projekti ka pasë një kosto të caktuar buxhetore mirëpo ne nuk e kemi pasë komplet të qartë se sa mjete financiare do të investoj Ministria e cekur sepse as ata prej fondit të tyre që e kanë nuk e kanë dhënë atë informatën se sa mjete buxhetore do të arritin t'i ndajnë për Podujevën, kurse tani me Marrëveshjen për bashkëfinancim për këtë vit Ministria përkatëse ka 270,000.00€ ndërsa për vitin e ardhshëm ka 300,000.00€. do të thotë ne me bartjen e të hyrave vetanake që kemi pasë nga tejkalimi i parashikimeve për të hyrat vetanake në këtë vit i kemi bartur 200,000.00€ me vendimin e kaluar të këtij Kuvendi, ndërsa tani po i bartim edhe 151,443.9€. meqë ky projekt vazhdon edhe në vitin 2024 neve si Komunë na nevojitet edhe një shumë tjetër buxhetore sepse është imponuar edhe prej Ministrisë së cekur që rrjedhimisht ky projekt të jetë dy vjeçar, kështu që për diferencën që kemi do të kemi përmbylljen financiare dhe do ta shikojmë se a do ta inkuadrojmë në buxhetin e vitit 2023 apo do të kemi shtesë financiare nga Ministria përkatëse apo edhe neve do të na duhet t'i bartim mjetet nga të hyrat vetanake në vitin 2024.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, për një projekt bukur serioz edhe qasja nuk po duket serioze qoftë prej Komunës qoftë prej Ministrisë së Zhvillimit Rajonal ngase të fillohet projekti pa i pasë të qarta vijat buxhetore me logjiken që po niset me “rahmet”, na del pak buxhet, po i qesim disa mjete buxhetore, ju nuk e keni të qartë, Ministria nuk e ka të qartë dhe tani si projekt ka mbetur në mëshirë të fatit.

E them këtë ngase në rast se nuk do të na tepronin mjete buxhetore përkatëse apo të rastësisë që nuk kemi mjete buxhetore a keni pasë ndonjë plan konkret apo jo. Pra edhe vitet në vijim nuk ka diçka të qartë sa i përket një ndarje buxhetore për këtë projekt.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, sërish sqarime, theksoi, ne e kemi pasë të qartë kur jemi bazuar në të hyrat vetanake që ne sipas trendit e kemi pasë të qartë se po i tejkalojmë të hyrat vetanake për afër 500,000.00€ e që normalisht aty kemi planifikuar që të kemi ndarje buxhetore ashtu siç edhe kemi pasë këtë ndarje, mirëpo fillimisht kur e kemi pasë në diskutim këtë ndarje buxhetore ka qenë edhe si debat publik nëpër media dhe më gjerë se çfarë do të bëhet me këtë fondin 22 përkatësisht me këto të hyra vetanake të Komunës, mirëpo faktikisht ne kemi besuar dhe kemi menduar se me bartjen e parë të të hyrave vetanake edhe këtë pjesë të buxhetit prej 151,433.9€ që tani e kemi propozuar për bartje do të jetë pjesë e atij projekti, por krejt ajo që ka ndodh kemi një shtyrje të bartjes së këtyre të hyrave vetanake e që në një formë është me trendin e ndërtimit që bëhet sepse kemi ende mjete buxhetore që mund të paguhen sepse normalisht që dinamika e punimeve nuk është para buxhetit që ne e kemi në dispozicion.

Patjetër në vitin 2024 mjetet buxhetore që janë të Qeverisë në shumë 300,000.00€ të zotuar dhe që mund të ketë shtesë, mirëpo diferenca që neve na mbetet në shumë rreth 230,000.00€ pa ndonjë problem e mbulojmë qoftë duke e inkuadruar në buxhetin e viti 2024, pra na mbetet të shikojmë edhe njëherë a po paraqitet nevoja për këtë gjë apo Qeveria do të na financoj këtë projekt me buxhet shtesë, nëse jo ne atëherë mund të bartim të hyrat vetanake sërish në muajin mars 2024.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, mund të them se dinamika e punimeve te Stacioni i Autobusëve ka ngeçë, kurse te ato projekt që janë donacion po ecin më shpejt siç është rasti i ndërtimit të Emergjencës.

Për Stacionin e Autobusëve ka dal si informatë se për atë pronë ka pasë edhe një kontest gjyqësor.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, unë tani po foli në emër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, dhe sa jam i informuar ka qenë një problem tek lart përçuesit apo shtyllat elektrike që janë të vendosura në atë pjesë. Pra në aspektin buxhetor unë dhashë sqarimet dhe nuk e besoj se do të kemi ndonjë problem sa i përket financimit të këtij projekti.

znj.Saranda Stublla, Drejtoresh e DPKGJ, theksoi, sa i përket pronave që janë në kontest gjyqësor, kur kemi të bëjmë me interes të përgjithshëm vetëm nëse ka masë të sigurisë e ndalon një projekt, andaj përderisa nuk ka masë të sigurisë nuk e ndalon asgjë Komunën që të investoj në atë pronë.

Nëse pronari pretendues e fiton atë pronë në gjykatë atëherë shteti duhet të merret me kompensimin financiar për atë pronë, mirëpo përderisa nuk ka masë të sigurisë projekti vazhdon të realizohet.

z.Naim Çunaku, theksoi, jemi në dijeni për procedurat e bartjes së të hyrave vetanake dhe e kemi bërë një bartje ndërsa tani kemi bartjen e një pjese tjetër të të hyrave për të cilat jeni në dijeni për ato makinacionet që janë bërë në Kuvendin e republikës së Kosovës dhe nuk po dëshiroj të hyjë në atë temë fare.

Ashtu siç e potencoj kolegu parafolës edhe unë po e them, nuk kam qëllim ta akuzoj dikë por qëllimi im është ta përmirësoj dikë nëse ai e sheh të arsyeshme.

Dua të them se nuk mund ta ndërtosh një projekt pa mjete financiare, pa zotim të mjeteve financiare dhe pa planifikim të sakt të mjeteve buxhetore se nga ku merren. Çka nëse nuk do të lëshoheshin këto mjete buxhetore e që ka qenë mëdyshje se a do t’iu lejohet Komunave të bartin apo do t’iu merren.

Çështja tjetër, jeni në dijeni se Komuna e Podujevës nuk ka fond emergjent, disa Komuna e kanë një fond të tillë dhe për këtë jam i sigurt, kurse tani jemi në fazën kur patëm një vërshim në Komunën tonë ku kam qenë edhe unë personalisht i atakuar e që për këtë kërkoj të mos keqkuptohem, mirëpo kur kam parë banorë me vaj në sy të cilëve i’u ka hyrë uji nëpër shtëpitë e tyre dhe Komuna jonë të mos ketë asnjë

vendim përmes të cilit sado pak me një shumë simbolike t'iu del në ndihmë atyre familjeve, mua më duket se nuk jemi për qytetarin.

Unë mendoj s enjë pjesë e këtyre mjeteve buxhetore, pasi që janë të pashfrytëzuara është dashtë t'i orientojmë si Kuvend për këtë çështje dhe këtë nuk mund të ndalon askush, në mënyrë që sado pak ta zbusim gjendjen e atyre familjeve apo të paktën ta kuptojnë ata se dikush e ka parë atë gjendje që i'u ka ndodh atyre.

E kam parë Ministrin e Ministrisë së Infrastrukturës bashkë me 2 Drejtor të cilët ishin dal vizitonin shtëpitë e prekura dhe atë ditën e dytë ose të tretë, në rregull është kjo mirëpo ai Ministër në rend të parë kishte me qenë mirë ta shihte urën që është dëmtuar sepse për atë është, ndërsa i'u thojke njerëzve ejani nesër në Komunë, dhe tani unë pyes a ka fond Komuna për atë punë, përse të mashtrohen qytetarët

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, i'u është bërë thirrje të vijnë në Komunë dhe t'i paraqesin kërkesat e tyre të cilat pastaj shkojnë në Qeveri për kompensim.

z.Naim Çunaku, vazhdoi, të më tregoj ndokush se a ka shpallë Komuna jonë mundësi të aplikimit për të gjithë ata që kanë pasë dëme nga vërshimet, nuk ka pra.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, theksoi, po po është bërë thirrje për të paraqitur kërkesat për vlerësim të dëmeve nga vërshimet.

z.Naim Çunaku, vazhdoi, nëse po i nderuar drejtor i DBF, atëherë gjema atë.

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi, lidhur me këtë konsideroj se po mendohet për ftesën publike sikur që ka ndodh në vërshimet e kaluara.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, fatkeqësisht e kanë mësuar këtë ngase po ndodh shpesh të ketë vërshime dhe tani janë në dijeni.

z.Naim Çunaku, theksoi, jo nuk është ashtu i nderuar Drejtor sepse qytetarët nuk e dinë këtë gjë, madje t'i jap dy shembuj që nuk kanë ardh për të paraqitur kërkesat e tyre edhe pse shtëpitë e tyre kanë qenë të përfshira nga vërshimet, madje kanë qenë në dijeni por nuk kanë ardhur sepse jemi në dijeni për fazën paraprake se çfarë është bërë me atë raportin e përgatitur e që nuk janë paguar fare, për të mos thënë ka qenë vetëm një mashtrim qytetarëve.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Nga 9 anëtarë/e të KPF-së, me 6 vota PËR (të tjerët nuk morën pjesë në votim) i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

4. Propozim vendimi për faljen e obligimeve të krijuara / borxheve nga qiratë në Tregun e Qytetit të Podujevës

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, duke paraqitur këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, paraprakisht atë po dëshiron ta potencoj z.Qëndrim Softolli rreth kësaj pike e që në një aspekt tjetër ndoshta është edhe me të drejtë ajo, pra arsyeja përse bëhet fjalë për faljen e borxheve në Tregun e Qytetit është sepse kur është ndërtuar ai treg janë lidh disa kontrata me shfrytëzuesit e atyre lokale, pjesa dërmuese e atyre lokaleve nuk janë shfrytëzuar asnjëherë nga ata që i kanë marrë me qira dhe rrjedhimisht ne të gjithë jemi dëshmitar që ai treg nuk gjeneron asgjë për ata persona të cilët i kanë marrë ato lokale.

Në bazë të një raporti që e ka paraqitur Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë pjesa dërmuese e tyre janë tezga të cilat nuk janë shfrytëzuar ndërsa atyre qytetarëve që kanë lidh një kontratë për shfrytëzim i'u është akumuluar një borxh që në fakt është një borxh fiktiv që për ne pothuajse është edhe i pa inkasueshëm si dhe mund të themi se disi është një barrë e pa merituar për ata persona sepse nuk kanë gjeneruar asgjë prej asaj pune, pra nuk i kanë përdorë ato lokale apo ato tezga, prandaj kjo ka qenë arsyeja që ne kemi propozuar të falen komplet obligimet për ata qytetar sepse tani faktikisht po e kanë tani edhe

njëfarë barre psikologjike për një borxh të akumuluar të cilin as nuk mundën ta paguajnë e as nuk kanë përfituar asgjë prej atij asemi të cilin e kanë përdorur.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, nëse këto borxhe po falen tani, në rregull kemi dështuar edhe ne më parë dhe po dështoni edhe ju tani që të bëhet inkasimi i borxheve, mirëpo pyetja tani është, a falen këto borxhe dhe vazhdon serish e njëjta situatë, pra a vazhdon ngarkesa me atë tarifë apo janë të liruara ata persona nga Komuna tani e tutje. Ethëm këtë sepse ne sot mund t'i falim ato borxhe mirëpo nga nesër mund të na përsëriten sërish dhe të kemi sërish një situatë të njëjtë.

z.Fatlum Osmani, Drejtor i DBF, theksoi, ky propozim vendim ka të bëjë vetëm me faljet e obligimeve të akumuluar. Sa i përket asaj që e potencoj parafolësi ne mund të pajtohemi se është ashtu mirëpo nuk ka të bëjë me këtë propozim vendim. Problematika kryesore është që ai treg nuk është funksional

z.Bashkim Sylja, theksoi, sa unë jam në dijeni Komuna ka formuar një komision, për ato lokale do të bëhen kërkesa për t'i marrë në shfrytëzim.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, sa kuptova nga parafolësi është se atyre pronarëve ju janë ndërprerë kontratat që kanë pasë për shfrytëzimin e atyre lokaleve.

znj.Saranda Stublla, Drejtoresh e DPKGJ, theksoi, në seancën e kaluar të Kuvendit të Komunës kemi pasë për shqyrtim ku edhe është miratuar vendimi për dhënien në shfrytëzim të lokaleve në tregun e qytetit dhe për këtë është formuara edhe komisioni përkatës, pra vetëm për lokale kurse për tezgaja jo.

Pra për lokale do të bëhen kontrata të reja dhe ne si DPKGJ bashkërisht dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave do t'i mbikëqyrim vazhdimisht ato kontrata.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, unë mendova që këto borxhe po falen tani dhe situata e njëjtë do të vazhdon sërish ku sërish mund të akumulohen borxhe tjera.

znj.Saranda Stublla, Drejtoresh e DPKGJ, theksoi, sipas ligjit nëse 3 muaj nuk bëhen pagesa nga ana e shfrytëzuesit atëherë Komuna e ka të drejtën e shkëputjes së kontratës.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, i njëjti ligj ka qenë edhe më parë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, mendoj se nuk është dashtë që Komuna t'i lë ata persona të hyjnë në borxhe duke mbajtur ato lokale por pa i shfrytëzuar ato.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, nuk është se kam diçka kundër kësaj por qëllimi ishte vetëm sqarime shtesë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, do të ishte mirë që kjo të bëhej edhe për tezgat që gjenden në atë hapësirë.

znj.Saranda Stublla, Drejtoresh e DPKGJ, theksoi, sa i përket tezgave ne nuk kemi marrë veprime për t'i dhenë në shfrytëzim ato për arsye se sigurisht jeni në dijeni se tregu i qytetit do të bartet nga aty kurse ai lokacion është caktuar për ndërtimin e Qendrës Multifunkionale.

z.Bashkim Sylja, theksoi, nuk e kisha fjalën për ato që im ceku drejtoresha, mirëpo për tezgat që gjenden brenda tregut e që mund të them se ka manipulime me to sepse e merr dikush tjetër në shfrytëzim i cili pastaj e lëshon me qira

znj.Saranda Stublla, Drejtoresh e DPKGJ, theksoi, edhe ato tezgaja i kemi paraparë në Listën e veçantë të pronave që parashihen për dhënie në shfrytëzim në këtë vit dhe tani jemi të obliguar të marrim veprime dhe t'i japin në shfrytëzim edhe ato tezgaja.

Kryetari i Komunës ka formuar një komision në DPKGJ, komision i cili ka dalë në terren dhe ka verifikuar të gjithë se si shfrytëzojnë ato tezgaja për çka është bërë raport.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nuk është në rregull nëse ndokush e ka marrë me qira dhe të njëjtën e ka lëshuar dikujt tjetër me qira kurse shtetit / komunës nuk i ka paguar qiranë e shfrytëzimit.

z.Naim Çunaku, theksoi, në këtë rast qiramarrësi nuk ka të drejtë ta bartë tek peroni i tretë fare

znj.Drita Pajaziti, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim

Njëzëri me 9 vota PËR, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhje.

5. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal afariste në qytet rr. “Skënderbeu”

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

znj.Saranda Stublla, Drejtoresh e DPKGJ, duke paraqitur fjalën hyrëse rreth kësaj pike, theksoi, kemi 2 lokale në parcelën 244-1 të cilat kërkohet të jepen në shfrytëzim. Tek neni 1 i këtij propozim vendimi kërkohet të hiqet shprehja “tregu i qytetit” sepse bëhet fjalë për 2 lokale afariste në rr.”Skënderbeu” por që është lëshuar gabim teknik gjatë përpilimit të propozim vendimit.

Gjithashtu kemi propozuar edhe formimin e komisionit për zhvillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të këtyre 2 lokaleve në kuadër të të cilit 1 anëtar duhet të përfshihet nga shoqëria civile e që kemi publikuar shpalljen publike për aplikim ku afati për aplikim është deri nesër, andaj i propozoj KPF-ës që t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të këtij propozim vendimi, përfshirë edhe propozim vendimin për formimin e komisionit në fjalë.

Lokalet në fjalë janë me ortofoto dhe foto me materialin përkatës, si dhe të njëjtat janë në listën e veçantë të pronave që parashihen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2023

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, fjala është për 2 lokale që gjenden në afërsi të Shkollës “Dr Ibrahim Rugova”

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së përkrahim këtë pikë të endit të ditës, fjala është për 2 lokale afariste me 50m² dhe 55m² dhe mendojmë se është më mirë që ato të funksionalizohen dhe në të njëjtën kohë ndokush të krijoj të hyra nga ato lokale.

Në mbledhjen e Kuvendit formohen komisionet përkatëse andaj emrat e anëtarëve do të propozohen në mbledhjen e Kuvendit, andaj e përkrahim që kjo pikë e rendit të ditës t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri me 9 vota PËR, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe formimin e Komisionit në fjalë me emrat e anëtarëve që do të propozohen dhe me korrigjimin e nenit 1 të këtij të këtij propozimi dhe atë, në pjesën e fundit pjesa ku thuhet ...Tregun e Qytetit, të fshihet...” .

6. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00495-4 Lupç i Poshtëm

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për formimin e komisioneve mendoj që nuk është nevoja të diskutojmë sot sepse në mbledhjen e Kuvendit do të paraqiten propozimet e anëtarëve ku edhe formohen këto komisione për këto çështje, mirëpo paraprakisht duhet të miratohen propozim vendimet për përkatëse e pastaj komisionet veç e veç për secilin vendim

znj.Saranda Stublla, Drejtoresh e DPKGJ, duke paraqitur fjalën hyrëse, theksoi, edhe për këtë pikë të rendit të ditës ju është përcjellë materiali përkatës, janë procedura që zhvillohen nga ana e komisionit.

Meqë edhe dy pikat vijuese janë të ngjashme dhe bëhet fjalë për lokalitetin e njëjtë, nëse më lejohet do ta paraqes fjalën hyrëse edhe për 2 pikat vijuese.

Pra kemi parcelën me nr.495-4 me sipërfaqe 2.84.03 ha; parcelën me nr.202-1 me sipërfaqe 4.47.73 ha; si dhe parcelën me nr.209-0 me sipërfaqe 3.38.82 ha. Parcela këto në zonën kadastrale Lupç i Poshtëm dhe

që të tria janë ngjitur njëra tjetrës si dhe të cilat parashihen në listën e veçantë për dhënie në shfrytëzim në vitin 2023, andaj propozoj që t'i rekomandohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim duke përfshirë edhe formimin komisioneve përkatëse.

z.Bashkim Syla, theksoi, kam pyetje për drejtoreshën e DPKGJ, sa jam në dijeni këto prona kanë qenë edhe vitin e kaluar si propozime për dhënie në shfrytëzim por nuk jam në dijeni se a ka pasë të interesuar për t'i marrë në shfrytëzim. E di se kjo çështje është obligim ligjor i juaji si DPKGJ, mirëpo vetëm deshta të di a ka pas të interesuar për ato prona.

znj.Saranda Stublla, Drejtoresh e DPKGJ, theksoi pas miratimit të vendimeve përkatëse Komuna shpall thirrjen për aplikim dhe janë procedura që parashihen me ligj që të zbatohen nga ana e Komisionit përkatës. Në vitin e kaluar këto prona kanë qenë në kuadër të Listës së veçantë por nuk janë proceduar në Kuvend për miratim paraprak, mirëpo tani janë të përcaktuara edhe me Hartë Zonale se çfarë parashihet në ato prona, pra edhe në këtë vit janë në kuadër të Listës së veçantë dhe janë proceduar për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grupi i LVV-së i përkrahim këto 3 pika të rendit të ditës (6, 7, 8) që t'i rekomandohen Kuvendit për shqyrtim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën konsideroj se sqarimet e nevojshme u dhanë për këto tri pika, pikat 6, 7 dhe 8, andaj i hedhim në votim veç e veç.

Njëzëri me 8 vota PËR, (nga anëtarët sa ishin prezent në sallë), i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe formimin e Komisionit në fjalë me emrat e anëtarëve që do të propozohen.

7. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00202-1 Lupç i Poshtëm
-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

Njëzëri me 8 vota PËR, (nga anëtarët sa ishin prezent në sallë), i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe formimin e Komisionit në fjalë me emrat e anëtarëve që do të propozohen.

8. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00209-0 Lupç i Poshtëm
-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

Njëzëri me 8 vota PËR, (nga anëtarët sa ishin prezent në sallë), i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe formimin e Komisionit në fjalë me emrat e anëtarëve që do të propozohen.

9. Propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit të FSK-së në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, anëtari nga FSK që ka qenë ka shkuar në detyrë të re kështu që duhet të zëvendësohet me një anëtar/e tjetër nga radhët e FSK-së i cili është sjellë / propozuar nga FSK-ja. Materialin e keni marrë besoj të gjithë dhe keni mund ta vëreni dhe të shihni emrat, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Njëzëri me 9 vota PËR, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

10. Draft Plani i Integritetit 2023 – 2027 për Komunën e Podujevës.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, ky dokument është proceduar në Kuvend për shqyrtim dhe miratim final pasi që ka kaluar gjitha proceduar paraprake duke përfshirë edhe fazën e konsultimeve publike.

Materiali i këtij dokumenti besoj se ju është përcjellë të gjithëve me kohë dhe shpresoj se keni pasë kohë të mjaftueshme ta lexoni dhe analizoni, andaj propozoj edhe njëherë që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim final të këtij dokumenti.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim Draft Planin e Integritetit 2023-2027 dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim. Sugjerimet dhe vërejtjet tona do t'i japim në mbledhjen e Kuvendit.

Njëzëri me 9 vota PËR, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15

Procesverbalin e mbajti;

Enis Sheholli

Nr.prot.01-060/04-0043445/23

Podujevë,

27 qershor 2023

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit

Hilmi Hoxha